



Informacione mbi vetë-testin për Coronavirus

Versioni: 01. Prill 2021

Ju keni blerë një vetë-test për Coronavirus në farmacinë tonë. Ne ju lutemi që ti kushtoni vëmendje këshillave të rëndësishme të listuara më poshtë. **Vetë-testi nuk zëvendëson rregullat e higjienës, ruajtjes së distancës dhe të sjelljes dhe konceptet ekzistuese të mbrojtjes.**

Çfarë duhet pasur parasysh në lidhje me përdorimin e vetë-testit?

Vetë-testet kanë krahasuar me testet PCR një përqindje shumë më të ulët zbulimi dhe për këtë arsye kanë një domethënie më të ulët – sidomos në rastin e personave pa simptoma.

Kur bën sens përdorimi i një vetë-testi?	<ul style="list-style-type: none">Në rastin e personave pa simptoma dhe pa kontakt me rastet e Covid-19, të cilët dëshirojnë të kryejnë një test në shtëpi.
Kur nuk duhet të bëhet një vetë-test?	<ul style="list-style-type: none">Vetë-testi nuk duhet të bëhet në rastin e personave të cilët kanë simptoma të sëmundjes. Këto të fundit duhet të kryejnë një test PCR ose një test të shpejtë antigjeni në një spital, një klinikë, një qendër testimi ose një farmaci.Mos kryeni një vetë-test para një vizite te personat që rrezikohen shumë dhe institucionet shëndetësore.Mos kryeni një vetë-test në rastin e testeve të përsëritura në shkollë, ndërmarrje dhe institucione
Ku mund të sigurohen vetë-testet?	Dhënia e vetë-testeve kryhet në Zvicër vetëm nga ana e farmacive dhe duke treguar kartën e sigurimit shëndetësor.
Kush paguan për vetë-testet?	Konfederata merr përsipër shpenzimet, jo sigurimet shëndetësore. Prandaj ju nuk jeni i detyruar të paguani asgjë vetë.
Sa vetë-teste mund të merren në farmaci?	Konfederata merr përsipër shpenzimet për maksimumi 5 vetë-teste për çdo person brenda 30 ditëve . Nuk ekziston mundësia e marrjes paraprake (p.sh për pushime), dhe edhe më vonë, nëse ju në 30 ditët e fundit keni marrë më pak se 5 teste.
A lejohem unë që të marr me shpenzimet e mia më shumë se 5 vetë-teste?	Jo, në hapin e parë ndodhen në dispozicion vetëm 5 vetë-teste për çdo 30 ditë për çdo person.
A lejohem unë që të marr në farmaci vetë-teste për persona të tjerë (p.sh. për pjesëtarë të familjes)?	Për sa kohë ju posedoni një kartë të sigurimit shëndetësor kjo gjë është e mundur. Por faturimi kryhet për çdo person individual të siguruar (nuk bëhet një përmbledhje për të gjithë familjen).
Si e përdor unë vetë-testin në mënyrë të saktë?	Përdorimi është përshkruar në fletën informuese që gjendet në kuti. Më kodin QR që gjendet ndodhet këtu ju mund të shihni një video sqaruese.
Rezultati i vetë-testit tim është pozitiv Çfarë duhet bërë?	<p>➔ Rezultati duhet të konfirmohet menjëherë me një test PCR. Ky test PCR konfirmues është gjithmonë falas.</p> <p>Ju lutemi testohuni menjëherë. Kodi QR: Ku mund të testohem unë?</p> <p>➔ Ju lutemi vetë-izolohuni deri në marrjen e rezultatit konfirmues PCR.</p>
Rezultati i vetë-testit tim është negativ Çfarë duhet bërë?	<p>➔ Vazhdoni të respektoni rregullat e higjienës, distancimit dhe të sjelljes së Autoriteti Federal të Shëndetit (BAG).</p> <p>➔ Rezultati juaj i testit është i vlefshëm vetëm ditën e testit. Në rast se keni simptoma testohuni në një spital, një klinikë, një qendër testimi ose në një farmaci. Informohuni në faqen informuese të Corona të kantonit tuaj.</p>



Vula e farmacisë

Në rast se keni pyetje apo paqartësi, farmacia juaj është aty për ju.

Sonnen Apotheke AG
Sonnenplatz 1
6020 Emmenbrücke